



Date: me 31.10.2022

Op. Donohor

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE
MINISTRI

Nr. 9231 prot.

Datë 31.10.2022

UDHËZIM

Nr. 608 datë 31.10.22

PËR

NJE NDRYSHIM NË UDHËZIMIN NR. 481, DATË 27.06.2019 "PËR PROCEDURAT E PUNËSIMIT PËR PROFESIONET E SHKENCAVE MJEKËSORE TEKNIKE NË INSTITUCIONET SHËNDETËSORE PUBLIKE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË, TË NDRYSHUAR"

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, bazuar në ligjin nr. 10 107, datë 30.3.2009 "Për kujdesin shëndetësor në Republikën e Shqipërisë",

UDHËZOJ:

Në udhëzimin nr. 481, datë 27.06.2019 "Për procedurat e punësimit për profesionet e shkencave mjekësore teknike në institucionet shëndetësore publike në Republikën e Shqipërisë, të ndryshuar", bëhen këto ndryshime si më poshtë:

1. Në Kreun IV, Procedura e përzgjedhjes së vendit të punës dhe emërimi i profesionistëve të shkencave mjekësore teknike, pika 4 ndryshon dhe bëhet:

"Kandidati, i cili në renditjen e përgjithshme të portalit, sipas NJVKSH-ve, është renditur me numrin më të madh të pikëve në profilin që ka aplikuar, ka të drejtën për të qenë i pari në përzgjedhjen e vendit të lirë të punës në institucionet shëndetësore përkatëse, sipas udhëzimit të OSHKSH. Kandidati që nuk paraqitet, mbetet në listën e pritjes me të njëjtat pikë për një periudhë deri 2(dy) vjet".

2. Në Kreun IV, Procedura e përzgjedhjes së vendit të punës dhe emërimi i profesionistëve të shkencave mjekësore teknike, bëhen këto ndryshime si më poshtë:

Pika 8/gërma a, ndryshohet dhe bëhet:

"Kandidati, i cili ka përzgjedhur një vend pune si zëvendësues në profilin përkatës (leje barrë lindje, pezullime etj), qëndron në atë pozicion deri në përfundimin e kontratës së përkohshme dhe me përfundimin e saj, rikthehet në listëpritje në përputhje me pikët e situara".

Pika 9, ndryshohet dhe bëhet:

Në rast se do të ketë vende të lira pune të cilat do të refuzohen nga të gjithë kandidatët fitues, ose kur shteron lista e pritjes, këto pozicione mund të plotësohen nga kandidatë të licensuar në profilin përkatës, me emërim të përkohshëm deri në ardhjen e një kandidati fitues nga portali. Në rast se në një profil të caktuar nuk do të ketë asnjë kandidat të licensuar që pranon të punësohet për vende vakante në zonat rurale, këto pozicione do të plotësohen me kandidatë të njërit nga profilet e teknikëve të shkencave

mjekësore, deri në plotësimin e këtij pozicioni me kandidatë të profilit përkatës nga portali “Infermier për Shqipërinë”. Në këto raste NJVKSH i drejtohet me kërkesë DROSHKSH, e cila pas një vlerësimi e përcjell kërkesën për miratim emërimi të përkohshëm pranë DQOSHKSH.

3. Në shtojcën nr.3, Kriteret dhe skema e vlerësimit të kandidatëve për ushtrimin e profesioneve të shkencave teknike mjekësore, bëhet shtesa si më poshtë:

Pas pikës 4, shtohet pika 4.1 me këtë përmbajtje:

4.1	Studime “Maister në infermierinë familjare”, 7 pikë (deri në 30 pikë gjithsej për vlerësimin e dosjes)	7 pikë
-----	--	--------

Ky udhëzim llym në fuqi menjëherë dhe botohet në fletoren zyrtare.

